



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2337, date 30.07.2013

Per

“Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. _____, në mbledhjen e datës 30.07.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Vlerësimin e pozitës dominante në tregjet perkatese të sipërmarrësit Altelecom Sh.a., mbi bazën e Dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”, si dhe vendosjen e masave rregulluese”.

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës, të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues;
- ii. Dokumenti “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”;
- iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);

- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
- 3) Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;
- 4) “Rregullore për analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, të Keshillit Drejtues të AKEP (*Rregullorja*).
- 5) Vendim Nr. 2138 date 2.08.2012, Për “*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Konsultim Publik*”
- 6) Vendim Nr. 2336 date 30.07.2013, Për “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V E R E N:

1. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*” reflekton punën e Grupit të Punës si dhe komentet dhe vërejtjet e bëra gjatë mbledhjes.
2. Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”,
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 02.08.2012-02.10.2012 dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
 - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikën më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar të telefonisë fikse;

- f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

A T E H E R E:

Për sa më sipër, mbi bazën e vlerësimit të pozitës në tregjet përkatëse të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., sipas Dokumentit “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2336 datë 30.07.2013, të përcaktojë sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., sipërmarrës me FNT në tregjet e mwposhtwme:

- 1.1 Tregu me pakice i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;
- 1.2 Tregu me pakice i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.
- 1.3 Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .
- 1.4 Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve ne rrjetin publike telefonike te Albtelecom te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 1.5 Tregu me shumice i sherbimeve tranzite ne rrjetet telefonike publike fikse.

Zona gjeografike e tregjeve përkatës është kombëtare apo territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Sipërmarrësi Albtelecom sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, ne tregjet e e nivelit te pakices per aksesin dhe thirrjet nga venddodhje fikse (tregjet 1.1 dhe 1.2), është i detyruar të zbatoje të detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:

2.1 Detyrimin e mosdiskriminimit

Albtelecom nuk duhet:

- Te diskriminoje ne menyre te pajustificuar midis grupeve te ndryshme te pajtimitareve;
- Te ofroje paketa (bundles) ne menyre te detyruar per pajtimitaret pa mundesi zgjedhje/blerje te sherbimeve te vecanta.

2.2 Detyrimin e transparencës:

Albtelecom ka detyrim njoftimit në AKEP 1 muaj para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në paketën tarifore aktuale standard "Familjare".

2.3 Detyrimin e ofrimit të Z(P)B për pajtimtarët.

Albtelecom të ofrojë këto shërbime për pajtimtarët sipas përcaktimeve të Rregullores dhe Udhezimeve për Z(P)B.

3. Sipermarrësi Albtelecom sh.a. i përcaktuar sipermarrës me FNT, në tregjet e nivelit të shumicës (1.1-1.5), është i detyruar të zbatojë detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:
 - Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
 - Detyrimi i transparencës (Neni 40);
 - Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41);
 - Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
 - Detyrimi për zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit (neni 43);
 - Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45);

3.1. Detyrimi i Mosdiskriminimit nënkupton:

- Sipermarrësi Albtelecom Sh.a., të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipermarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipermarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me çilesi të njëjta, sikunder ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij
- Sipermarrësi Albtelecom Sh.a., të perditesojë Ofertën Reference të Interkoneksionit, për ta pershtatur me përcaktimet e këtij vendimi dhe me ndryshimet dhe nevojat e tregut, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- Sipermarrësi Albtelecom Sh.a., të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesorë të Performancës (Key Performance Indicators -KPI) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit.

3.2. Detyrimi i transparencës:

Oferta Reference e Interkoneksionit e perditesuar nga Albtelecom duhet të përshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për interkoneksion me Albtelecom:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

3.3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit:

Sipermarresi Albtelecom Sh.a., per terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve ne rrjetin Albtelecom, duhet:

- a) t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke lejuar, ndërmjet të tjerash, zgjedhjen dhe/ose parazgjedhjen e bartësit dhe/ose ofertat e rishitjes së linjës së pajtimtarit;
- b) te mos anuloje aksesin ne facilitetet, kur e ka dhene ate;
- ç) te negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) te ofroje akses te hapur ne nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjite e tjera te rendesishme, te domosdoshme per nderveprimin e sherbimeve ose per sherbimet e rrjetit virtual;
- dh) te ofroje bashkevendosje ose forma te tjera te perdorimit te perbashket, perfshire ndertesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- e) te krijojë kushtet e nevojshme per te siguruar nderveprimin e sherbimeve pike fundore – pike fundore, duke perfshirë facilitetet per sherbimet e rrjetit inteligjent ;
- ë) te ofroje akses ne sistemet mbeshtetese funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (software), te nevojshme, per te siguruar konkurrence te ndershme ne ofrimin e sherbimeve;
- f) te interkonektoje rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

Detyrimet e mesiperme, i referohen vetem detyrimeve per mundesimin e terminimit te thirrjeve kombetare, origjinimit te thirrjeve dhe tranzitimit te thirrjeve kombetare ne rrjetin fiks Albtelecom, dhe jane te zbatueshme sipas mundesive/aftesive teknike dhe ekonomike te sipermarresit Albtelecom Sh.a.

3.4. Detyrimi per zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit:

Albtelecom ka detyrimin t'u ofroje operatoreve te tjere sherbime te zgjedhjes/parazgjedhjes se bartesit te thirrjeve sipas percaktimeve te Rregullores dhe Udhezimeve per Z(P)B.

3.5 Detyrimet për mbajtje te llogarive te ndara, kontroll të tarifave dhe orientim ne kosto

- i) Tarifat e sherbimeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me keto sherbime në rrjetin publik telefonik fiks te Albtelecom janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
- ii) Tarifat e sherbimeve te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve duhet te jene te orientuara drejt koston duke marre ne konsiderate investimin e bërë nga sipërmarrësi, perfshire një norme të arsyeshme fitimi mbi kapitalin e punësuar dhe riskun.
- iii) Tarifat e sherbimeve me shumice te interkonksionit te jene sipas vlerave dhe afateve te dhena ne tabelen e meposhteme:

Tabela 1: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Altelecom 2014-deri ne nje vendim tjetër te AKEP

	Aktuale-31.12.2013	Faza I	Faza II
		1.01.2014-31.08.2014	1.09.2014-deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Terminim – Origjinim (lek/minute)			
Lokal	1.50	1.34	1.19
Njefish	2.50	1.34	1.19
Dyfish	3.50	2.68	1.85
Tranzitim(lek/minute)			
Njefish	1.50	1.71	1.32
Dyfish	2.50	1.71	1.32
Tarifë fikse për thirrje¹(lek/thirrje)			
Tarife per thirrje	0.83	0.53	0.38

Tarifat jane shprehur pa TVSH

- iv) Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 41 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit të orientimit në kosto të tarifave të interkoneksionit (neni 59), nga Altelecom sh.a, do të kryhet në baze të përcaktimit të mëvonshme të AKEP.
- 4 Siper marrësi Altelecom Sh.a. ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave të tregut, për statusin e FNT në tregjet përkatëse të përcaktuar me status me FNT.
- 5 Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT në tregjet përkatëse për siper marrësin Altelecom Sh.a., është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut të kryer sipas nenit 34 të Ligjit 9918.
- 6 Në përputhje me nenin 34 të ligjit 9918 dhe pikën 5 të nenit 3 të Rregullores për Analizën e Tregut:

¹ Aplikohet për terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

- 6.1 Detyrimet e sipërmarrësit Albetelcom sh.a. për kontrollin e tarifave të aksesit dhe të thirrjeve telefonike nga venddodhje fikse për tregjet me pakice, përcaktuar në vendimin nr.1348, datë 26.07.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP, hiqen.
 - 6.2 Heqja e detyrimeve të cituar në pikën 6.1 me sipërbehet efektive më 1.01.2014.
 - 6.3 Detyrimet e Albetelecom sh.a. për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcaktuara në vendimin nr.1348, datë 26.07.2010, i amenduar, hiqen.
 - 6.4 Heqja e detyrimeve të cituar në pikën 6.3 më sipër bëhet efektive më 1.09.2013.
-
- 7 Dokumenti “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar*” i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneks 1 dhe është pjesë e tij.
 - 8 Vendimi nr.1348, datë 26.07.2010 i Këshillit Drejtues të AKEP shfuqizohet.
 - 9 Kundra këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
 - 10 Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Elkeda DOMI**
- 4. Zamira NURCE**



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE E TREGUT TE TELEFONISE FIKSE

- 1) Tregu i aksesit ne rrjet publik telefonik nga vendodhje fikse;
- 2) Tregu i thirrjeve telefonike te vlefshme per publikun nga vendodhje fikse.
- 3) Tregu me shumice i origjinimit te thirrjeve ne rrjetin telefonik publik te ofruara nga vendndodhje fikse .
- 4) Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve per rrjete publike telefonike individuale te ofruara nga vendndodhje fikse.
- 5) Tregu me shumice i sherbimeve tranzite ne rrjetet telefonike publike fikse.

Dokument Perfundimtar

Korrik 2013

(MIRATUAR ME VKD NR.2336 DATE 30.07.2013)

Publikuar ne faqen e Internetit te AKEP, www.akep.al, ne seksionin 'Konsultime te Perfunduara'.